

PRISHTINË, TETOR 2021

TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

3

(Mos)informimi i publikut



TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA NË UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS

(Mos)informimi i publikut

Publikues:

ORCA - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Henrik Bariç, Nr. 6

Pristina, 10000, Kosova

Autore:

Liridona Ademaj

Hulumtues:

Skord Retkoceri

Adea Kondirolli

Ilir Konushevc

Dizajni:

Envinion



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje.....	9
Gjetjet kryesore	10
Pasqyrë e transparencës formale të universiteteve publike...	12
Universiteti i Prishtinës	14
Universiteti i Pejës	15
Universiteti i Mitrovicës	16
Universiteti i Prizrenit.....	17
Universiteti i Gjilanit.....	18
Universiteti i Gjakovës.....	19
Universiteti i Ferizajt.....	20

LISTË E SHKURTESAVE

UP	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
UHZ	Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
UPZ	Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
UGJFA	Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
UMIB	Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
UKZ	Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
USHAF	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
ORCA	Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

HYRJE

Shtatë universitetet publike në Kosovë, buxhetin e shtetit vazhdojnë ta kenë burim kryesor të të ardhurave financiare. Prandaj transparenca formale është hapi i parë drejt transparencës së mirëfilltë dhe llogaridhënies së këtyre institucioneve publike. Transparenca po ashtu ndikon edhe në afirmimin e tyre kundrejt studentëve të ardhshëm, por edhe publikut në tërësi.

Me transparençë formale në këtë dokument, kuptohet ofrimi i qasjes formale në informacion për publikun nga ana e universiteteve publike përmes faqeve elektronike të tyre.

Në këtë hulumtim apo matje, ORCA ka grumbulluar të dhëna mbi ekzistencën e njëzet e shtatë (27) dokumenteve dhe informacioneve të cilat janë publikuar ose do të duhej të publikoheshin nga ana e shtatë universiteteve publike (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjilanit, dhe Universiteti i Ferizajt), të cilat përbëjnë informacionin më bazik rreth funksionimit të tyre.

Të dhënat në këtë raport, janë grumbulluar gjatë muajit shtator të vitit 2021 nga ueb faqet zyrtare të shtatë universiteteve publike në vendin tonë.

I njëjti hulumtim apo matje është kryer nga ORCA edhe katër herë të tjera. Në muajin tetor të vitit 2020¹, në janar të vitit 2020², në muajin shtator të vitit 2019³ dhe në shkurt të vitit 2019⁴.

Bazuar në të dhënat e grumbulluara në këtë raport, mund të shihet se universitetet publike vazhdojnë të mos i kushtojnë rëndësi transparencës formale me palët e interesuara sa i përket publikimit të rregulloreve, vendimeve dhe informatave të nevojshme për publikun në përgjithësi. Dhe se përmirësimi në këtë aspekt është i ngadalshëm.

1 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut", tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

2 Raporti "Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

3 Raporti "Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit", shtator 2019, linku: www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf

4 Raporti "Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim", shkurt 2019, linku: www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf

GJETJET KRYESORE

Katër prej universiteteve publike në vendin tonë kanë pësuar rënie të transparencës formale apo publikimit të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për publikun. ORCA ka gjetur se kjo ndodh kryesisht për shkak të neglizhencës mirëpo edhe si rezultat i ndërrimit të ueb faqeve të tyre apo ndërhyrjeve të një natyre të ngjashme. Sido që të jetë, është detyrë e universiteteve që të sigurohen se informimi i publikut përmes faqeve të tyre është funksional dhe i mundshëm.

Dy universitete kanë treguar përmirësim në këtë matje të transparencës formale, Universiteti i Prizrenit nga 23 dokumente apo informacione të publikuara sa i kishte në raportin e kaluar tani ka 24, ndërsa Universiteti i Gjilanit nga 22 sa i kishte në raportin e kaluar tani ka 23 dokumente dhe informacione të nevojshme për studentët, stafin e universitetit dhe publikun në përgjithësi.

Universitetet më transparente në këtë matje janë Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Gjakovës, ndërsaq universiteti me më pak transparencë vazhdon të mbetet Universiteti i Ferizajt.

Gjetjet e hulumtimit apo matjes së transparencës formale për këtë raport, tregojnë se trembëdhjetë (13) prej njëzet e shtatë (27) dokumenteve apo informacioneve të listuara nga ORCA si më të rëndësishmet, janë të publikuara nga të gjitha universitetet publike në Kosovë.

Këto të dhëna janë publike në të shtatë universitetet: *Statuti i universitetit, Plani Strategjik, Kodi i Etikës, Përbërja e Parlamentit Studentor, Përbërja e Senatit, Përbërja e Rektoratit, Përbërja e Këshillit Drejtues, Rregullorja Disiplinore, Rregullorja për Studimet BA, Rregullorja për Studimet MA, Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë, Planprogramet dhe Informatat për Bursa/Punësim.*

Ndërkaq dokumentet që u mungojnë pesë (5) prej shtatë universiteteve publike janë *“Vendimet e Akreditimit”* mbi programet studimore që kanë marrë akreditim (Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Gjakovës dhe Universiteti i Ferizajt).

Kurse dokumentet që u mungojnë katër (4) prej shtatë universiteteve publike janë *“Rregullorja për SEMS”* (Universiteti i Pejës, Universiteti i Gjakovës, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Mitrovicës) dhe *“Rregullorja për PhD”* (Universiteti i Mitrovicës, Universiteti i Prizrenit, Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt).

Për krahasim, në raportin e kaluar vetëm Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Pejës kishin të publikuar Rregulloren për studime të doktoratës ndërsa tani këtë dokument e ka të publikuar edhe Universiteti i Gjakovës.

Në të kaluarën kur janë publikuar raporte të ngjashme, disa prej universiteteve publike janë ankuar lidhur me objektivitetin e raportimeve dhe gabimin e mundshëm metodologjik nga ana e ORCA-s, pasi ato kanë arsyetuar mungesën e rregulloreve për doktoratë me faktin se ato nuk kanë programe të tilla.

ORCA thekson se sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Kosovë⁵, një institucion i arsimit të lartë, për të qenë universitet duhet të ketë pesë programe për studime të doktoratës në pesë fusha të ndryshme studimi.

Ndërkohë që *“Vendimet e Rektorit”* u mungojnë ose nuk janë të përditësuara në vitet e fundit, tri (3) prej shtatë universiteteve publike (Universiteti i Pejës, Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Ferizajt).

Kurse dokumentet që u mungojnë nga dy (2) prej shtatë universiteteve publike janë *“Raporti student/mësimdhënës”* (Universiteti i Mitrovicës dhe Universiteti i Gjilanit), *“Rregullorja për bashkëpunëtorë”* (Universiteti i Mitrovicës dhe Universiteti i Ferizajt), *“Buletinet”* (Universiteti i Gjilanit dhe Universiteti i Ferizajt), *“CV-të e stafit”* (Universiteti i Prishtinës dhe Universiteti i Ferizajt), *“Buxheti”* (Universiteti i Prizrenit dhe Universiteti i Ferizajt), *“Vendimet e Senatit”* (Universiteti i Pejës dhe Universiteti i Ferizajt), si dhe *“Vendimet e Këshillit Drejtues”* (Universiteti i Pejës dhe Universiteti i Ferizajt).

Nëse i krahasojmë për nga numri i përgjithshëm i dokumenteve apo informacioneve bazike, nga matjet e tanishme të transparencës formale në universitete publike në vendin tonë me ato nga raporti i kaluar, del të jetë që pesë (5) prej tyre kanë rënë në numër derisa vetëm dy (2) prej tyre kanë pasur përmirësim.

Njëra ndër arsytet për këtë rënie transparence janë ndërrimet në vazhdimësi të uebfaqeve të universiteteve dhe mospërditësimi i tyre me dokumentet e nevojshme.

Në raportin e kaluar, nga 27 dokumente apo informacione Universiteti i Prishtinës i kishte të publikuara gjithsej 27 ndërsa tani i ka të publikuara vetëm 25.

Nga 27 dokumente apo informacione, Universiteti i Pejës i kishte të publikuara 25 ndërkaq tani ka vetëm 22. Edhe Universiteti i Mitrovicës i kishte 25 ndërsa tani i ka 22. Universiteti i Ferizajt i kishte 16 ndërkaq tani i ka 15. Universiteti i Gjakovës i kishte 25 dhe nuk është përmirësuar ka mbetur në numrin e njëjtë, pra 25.


Universiteti i Prizrenit nga 23 dokumente apo informacione të publikuara sa i kishte në raportin e kaluar tani ka 24, ndërsa Universiteti i Gjilanit nga 22 sa i kishte në raportin e kaluar tani ka 23 dokumente të publikuara.

⁵ Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë, 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

Pasqyrë e transparencës formale të universiteteve publike


Universiteti i:	Prishtinës	Pejë	Mitrovicës	Prizrenit	Gjilanit	Gjakovës	Ferizajt
1 Raporti student/ mësimdhënës	✓	✓	✗	✓	✗	✓	✓
2 Statuti i Universitetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
3 Plani strategjik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
4 Kodi i etikës	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
5 Rregullore disiplinore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
6 Rregullore për zgjedhjen e stafit akademik	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
7 Rregullore për bashkëpunëtorë	✓	✓	✗	✓	✓	✓	✗
8 Buletine	✓	✓	✓	✓	✗	✓	✗
9 CV-të e stafit	✗	✓	✓	✓	✓	✓	✗
10 Rregullore për të ardhura personale	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
11 Buxheti	✓	✓	✓	✗	✓	✓	✗
12 Rregullore për zgjedhjet studentore	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✗
13 Përbërja e Parlamentit Studentor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
14 Përbërja e rektoratit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
15 Përbërja e Këshillit Drejtues	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
16 Përbërja e Senatit	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
17 Vendimet e Senatit	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✗
18 Vendimet e Këshillit Drejtues	✓	✗	✓	✓	✓	✓	✗
19 Vendimet e Rektorit	✓	✗	✓	✗	✓	✓	✗
20 Vendimet e akreditimit	✗	✗	✗	✓	✓	✗	✗
21 Rregullore për studimet BA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
22 Rregullore për studimet MA	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
23 Rregullore për studimet PhD	✓	✓	✗	✗	✗	✓	✗
24 Rregullore për SEMS	✓	✗	✗	✓	✗	✗	✓
25 Rregullore për sigurimin e cilësisë	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
26 Planprograme	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
27 Info për bursa/punësim	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Indeksi	25/27	22/27	22/27	24/27	23/27	25/27	15/27

Numri i dokumenteve/informatave të qasshme për publikun përgjatë viteve



UNIVERSITETI I PRISHTINËS


SHKURT 2019



24

Në këtë matje të transparencës formale, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) ka rënë në publikimin e dokumenteve apo informacioneve bazike të funksionimit të universitetit. UP ishte njëra ndër universitetet publike që kishte më së shumti përmirësim në këtë aspekt, duke i publikuar të gjitha dokumentet dhe informatat e nevojshme gjatë matjes së kaluar.


SHTATOR 2019



24

Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Prishtinës aktualisht i ka të publikuara 25 në ueb faqen zyrtare të tij⁶.

JANAR 2020




25

Për dallim nga raporti i kaluar i publikuar nga ORCA në tetor të vitit 2020⁷, kur ky universitet i kishte të publikuara të gjitha informacionet dhe dokumentet e nevojshme, në këtë matje rezulton se UP-së i mungojnë “CV-të e stafit akademik” dhe “Vendimet e Akreditimit” mbi programet studimore që kanë marrë akreditim.

Në matjen e kaluar, Universiteti i Prishtinës ishte universiteti i vetëm publik në Kosovë në të cilin të gjithë të interesuarit për dokumente apo informacione, në ueb faqen e UP-së mund t'i gjenin të gjitha të dhënat e nevojshme.

TETOR 2020



27

Në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Prishtinës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin dy (2) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.⁸

Kurse në matjen e transparencës së universiteteve në shtator të vitit 2019⁹, Universitetit të Prishtinës i mungonin të dhëna për tri (3) dokumente dhe informacione të rëndësishme.

TETOR 2021



25

Ndërkaq në hulumtimin e publikuar në shkurt të vitit 2019¹⁰, UP përsëri kishte mungesë të tri (3) dokumenteve dhe informacioneve.

6 Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Prishtinës, linku: www.uni-pr.edu/

7 Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

8 Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

9 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

10 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

UNIVERSITETI I PEJËS

Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka” (UHZ) ka pësuar rënie në aspektin e transparencës formale, nga 25 dokumente dhe informata që i kishte të publikuara në matjen e kaluar UHZ ka rënë në 22. Që nga matja e parë nga ORCA në shkurt të vitit 2019, Universiteti i Pejës është përmirësuar gradualisht mirëpo kjo nuk po vazhdon të ndodhë më dhe shkaqet për këtë nuk janë të ditura.

Nga raporti i kaluar kur është bërë matja e publikimit të dokumenteve dhe informatave të nevojshme, del se situata është përkeqësuar në këtë drejtim, ku nga 25 dokumente dhe informacione sa i kishte, ka rënë në 22. Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Pejës aktualisht i ka të publikuara vetëm njëzet e dy (22) prej tyre në ueb faqen zyrtare¹¹.

Tani UHZ-së i mungojnë pesë (5) dokumente të rëndësishme. Bëhet fjalë për “Vendimet e Këshillit Drejtues”, “Vendimet e Senatit”, “Vendimet e Rektorit”, “Vendimet e akreditimit” mbi programet studimore që kanë marrë akreditim dhe “Rregullorja për SEMS”. Disa nga këto dokumente ekzistojnë vetëm të viteve të kaluara dhe nuk janë të përditësuar.

Ndërsa në matjen e kaluar të transparencës së universiteteve publike në tetor të vitit 2020¹², Universitetit të Pejës i mungonte vetëm një dokument, “Rregullorja për SEMS”. Në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e matjes mbi transparencën formale të universiteteve publike dhe në Universitetin e Pejës, mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.¹³ Në hulumtimin e kryer në shtator të vitit 2019¹⁴, UHZ-së i mungonin katër (4) dokumente.

Ndërkaq në matjen e transparencës formale në shkurt të vitit 2019¹⁵, ORCA kishte gjetur se në Universitetin e Pejës mungonin gjashtë (6) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

SHKURT 2019

21



SHTATOR 2019

23



JANAR 2020

23



TETOR 2020

26



TETOR 2021

22



¹¹ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Pejës, linku: www.unhz.eu/

¹² Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

¹³ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

¹⁴ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

¹⁵ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

UNIVERSITETI I MITROVICËS

SHKURT 2019



20



SHTATOR 2019



22



JANAR 2020



23



TETOR 2020



25



TETOR 2021



22

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” (UMIB) ka pësuar rënie në aspektin e transparencës formale apo publikimit të dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme. Nga hera e kaluar kur është bërë matja e publikimit të dokumenteve dhe informatave të nevojshme, rezulton se nuk ka pasur përmirësime në aspektin e transparencës në këtë universitet. Përkundrazi, situata është përkeqësuar duke ulur numrin e dokumenteve dhe informacioneve nga 25 në 22.

Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Mitrovicës aktualisht i ka të publikuara vetëm njëzet e dy (22) prej tyre në faqen zyrtare të tij¹⁶.

Në këtë universitet, ende nuk ka informacione rreth këtyre pesë (5) dokumenteve: “Raporti student/mësimdhënës”, “Rregullorja për bashkëpunëtorë”, “Vendimet e akreditimit”, “Rregullorja për studimet PhD” dhe “Rregullorja për SEMS”.

Për krahasim, në matjen e muajit tetor të vitit 2020¹⁷, UMIB kishte të publikuara gjithsej 25 informata dhe dokumente të rëndësishme. Ky universitet, ende nuk e kishte të publikuar “Rregulloren për studimet PhD” dhe “Rregulloren për SEMS”.

Në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Mitrovicës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin tri (3) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.¹⁸

Ndërsa në shtator të vitit 2019¹⁹, UMIB nuk kishte të publikuar pesë (5) dokumente të rëndësishme.

Dokumentet dhe informacionet që mungonin në shkurt të vitit 2019²⁰, në faqe zyrtare të Universitetit të Mitrovicës ishin shtatë (7).

¹⁶ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Mitrovicës, linku: www.umib.net/

¹⁷ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

¹⁸ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

¹⁹ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

²⁰ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

UNIVERSITETI I PRIZRENIT

Ky universitet ka pasur përmirësim në aspektin e transparencës nga hera e kaluar kur është bërë hulumtimi i publikimeve të dokumenteve të nevojshme meqenëse në këtë matje, nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti” (UPZ) është publikuar edhe një informacion për dallim nga 23 dokumente dhe informacione që ishin vitin e kaluar, duke mbërritur në 24.

Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Prizrenit aktualisht i ka të publikuara njëzet e katër (24) prej tyre në ueb faqen zyrtare²¹.

Tri dokumentet që i mungojnë janë “Buxheti”, “Vendimet e Rektorit” dhe “Rregullorja për studimet PhD”.

Në tetor të vitit 2020²², UPZ-së në faqen zyrtare i mungonin katër (4) dokumente të rëndësishme siç janë “Raporti student/mësimdhënës”, “Buxheti”, “Vendimet e Rektorit” dhe “Rregullorja për studime PhD”.

Edhe në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Prizrenit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.²³

I njëjti rezultat ka qenë edhe në matjen e radhës e cila ishte bërë në shtator të vitit 2019²⁴, ku UPZ-së i mungonin katër prej dokumenteve që nuk ishin të publikuara as në shkurt kur ishte bërë matja.

Ndërkaq në raportin e publikuar nga matja e transparencës formale në shkurt të vitit 2019²⁵, ORCA kishte gjetur se Universiteti i Prizrenit nuk i kishte publikuar tetë (8) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

²¹ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Prizrenit, linku: www.uni-prizren.com/

²² Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

²³ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

²⁴ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

²⁵ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

SHKURT 2019

19



SHTATOR 2019

23



JANAR 2020

23



TETOR 2020

23




TETOR 2021

24




SHKURT 2019




18

SHTATOR 2019




19

JANAR 2020



20

TETOR 2020



22

TETOR 2021



23

UNIVERSITETI I GJILANIT

Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka” (UKZ) ka përmirësim në aspektin e transparencës nga hera e kaluar kur është bërë hulumtimi i publikimeve të dokumenteve të nevojshme. Universiteti i Gjilanit tash ka të publikuara 23 dokumente dhe informacione krahasuar me 22 prej tyre që ishin në tetor të vitit të kaluar. Që nga matja e parë e bërë nga ORCA në shkurt të vitit 2019, UKZ vazhdon të ketë përmirësim gradual.

Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Gjilanit aktualisht i ka të publikuara njëzet e tri (23) prej tyre në faqen zyrtare të tij²⁶. Katër dokumentet e rëndësishme që i mungojnë këtij universiteti janë “Raporti student/mësimdhënës”, “Buletinet”, “Rregullorja për studimet PhD” dhe “Rregullorja për SEMS”.

Për krahasim, në tetor të vitit 2020²⁷, UKZ-së në faqen zyrtare i mungonin pesë (5) dokumente të rëndësishme siç janë “Raporti student/mësimdhënës”, “Buxheti”, “Vendimet e Këshillit Drejtues”, “Rregullorja për studime PhD”, si dhe “Rregullorja për SEMS”. Në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjilanit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin shtatë (7) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.²⁸

Në shtator të vitit 2019²⁹, Universiteti i Gjilanit kishte publikuar vetëm një dokument mirëpo, tetë (8) dokumentet të tjera që mungonin në shkurt, ende nuk ishin publikuar.

Ndërkaq në shkurt të vitit 2019³⁰, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjilanit, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntë (9) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

²⁶ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Gjilanit, linku: www.uni-gjilan.net/

²⁷ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

²⁸ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

²⁹ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

³⁰ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

UNIVERSITETI I GJAKOVËS

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” (UGJFA) nuk ka shënuar ndonjë ndryshim sa i përket publikimit të dokumenteve dhe informacioneve të nevojshme për palët e interesuara. UGJFA në matjen e kaluar kishte të publikuara gjithsej 25 lloje të dhënash ndërsa në këtë matje rezultoi se ky numër nuk ka pësuar ndonjë ndryshim. Pra nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Gjakovës aktualisht i ka të publikuara njëzet e pesë (25) prej tyre në faqen zyrtare të tij³¹.

Ky universitet ende nuk i ka të publikuara dy dokumente të rëndësishme, “Vendimet e akreditimit” mbi programet studimore që kanë marrë akreditim dhe “Rregulloren për SEMS”. Në tetor të vitit 2020³², UGJFA-së në faqen zyrtare i mungonin dy (2) dokumente të rëndësishme siç janë “Rregullorja për bashkëpunëtorë të jashtëm” dhe “Rregullorja për studimet PhD”.

Universiteti i Gjakovës nuk është përmirësuar për nga numri i publikimit të dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme sepse ngjashëm me matjen e kaluar, UGJFA ka vetëm 25 publikime mirëpo ajo që është vërejtur është se në matjen e kaluar dy dokumentet që mungonin ishin të tjera me ato që mungojnë në këtë matje.

Në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Gjakovës, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin katër (4) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.³³

Ndërkaq, në shtator të vitit 2019³⁴, UGJFA nuk kishte publikuar gjashtë (6) dokumente. Në matjen nga ORCA në shkurt të vitit 2019³⁵, Universitetit të Gjakovës i mungonin dymbëdhjetë (12) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

³¹ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Gjakovës, linku: www.uni-gjk.org/

³² Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>


³³ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

³⁴ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

³⁵ Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku: <http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>


SHKURT 2019

15




SHTATOR 2019

21




JANAR 2020

23



TETOR 2020

25




TETOR 2021

25




SHKURT 2019




8

SHTATOR 2019




8

JANAR 2020



8

TETOR 2020



16

TETOR 2021



15

UNIVERSITETI I FERIZAJT

Universiteti i Ferizajt mbetet njëri ndër universitetet me më së paku transparencë në mesin e universiteteve të tjera publike edhe pse në matjen e kaluar kishte shënuar përmirësim të dukshëm duke publikuar tetë lloje të dhënash të cilat nuk gjendeshin në matjet e kaluara. Nga njëzet e shtatë (27) dokumente apo informacione bazike rreth funksionimit të universitetit, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (USHAF) aktualisht i ka të publikuara vetëm pesëmbëdhjetë (15) prej tyre në ueb faqen zyrtare³⁶.

Këtij universiteti i mungojnë gjithsej dymbëdhjetë (12) dokumente dhe informacione të rëndësishme siç janë *“Rregullorja për zgjedhjen e stafit akademik”, “Rregullorja për bashkëpunëtorë”, “Buletinet”, “CV-të e stafit”, “Rregullorja për të ardhura personale”, “Buxheti”, “Rregullorja për zgjedhjet studentore”, “Vendimet e Senatit”, “Vendimet e Këshillit Drejtues”, “Vendimet e Rektorit”, “Vendimet e akreditimit” dhe “Rregullorja për studimet PhD”.*

Nga raporti i kaluar kur është bërë matja e publikimit të dokumenteve dhe informatave të nevojshme, del të jetë që nuk ka përmirësime në aspektin e transparencës në këtë universitet. Përkundrazi, situata është përkeqësuar nga 16 sa i kishte ka rënë në 15.

Në tetor të vitit 2020³⁷, USHAF-it në faqen zyrtare i mungonin njëmbëdhjetë (11) dokumente ose informata të tjera bazike që duhet publikuar secili universitet. Bëhej fjalë për *“Rregulloren për zgjedhjen e stafit akademik”, “Rregulloren për bashkëpunëtorë”, “Buletinet”, “CV-të e stafit”, “Rregulloren për të ardhura personale”, “Buxhetin”, “Vendimet e Senatit”, “Vendimet e Këshillit Drejtues”, “Vendimet e Rektorit”, “Vendimet e akreditimit” dhe “Rregulloren për studimet PhD”.*

Ndërkaq në janar të vitit 2020, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Ferizajt, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntëmbëdhjetë (19) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.³⁸

³⁶ Faqja zyrtare elektronike e Universitetit të Ferizajt, linku: www.ushaf.net/

³⁷ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut”, tetor 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/Mosinformimi-i-Publikut-2.pdf>

³⁸ Raporti “Transparenca dhe llogaridhënia në universitetet publike të Kosovës - (Mos)informimi i publikut, janar 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2020/01/02-Transparenca-n%C3%AB-Universitetet-Publike-t%C3%AB-Kosov%C3%ABs-ALB-02.pdf>

Në matjen e publikuar në shtator të vitit 2019³⁹, Universiteti i Ferizajt nuk i kishte publikuar nëntëmbëdhjetë (19) dokumentet apo informacionet e tjera.

Në shkurt të vitit 2019⁴⁰, ORCA kishte publikuar gjetjet e transparencës formale në Universitetin e Ferizajt, përmes të cilave ishte bërë e ditur se këtij universiteti i mungonin nëntëmbëdhjetë (19) dokumente apo informacione të rëndësishme në faqen zyrtare.

39 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim-afati i shtatorit”, shtator 2019, linku:<http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Monitorimi-i-universiteteve-publike-Afati-i-Shtatorit-2019.pdf>

40 Raporti “Transparenca formale e universiteteve publike-universitetet në provim”, shkurt 2019, linku:<http://www.orca-ks.org/wp-content/uploads/2019/02/Transparenca-formale-e-Universiteteve-publike.pdf>

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAINT”. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministërstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologji
Ministry of Education, Science and Technology

